

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1034 REP.
NR. 508/1 KOL.



KONTRATE SHIT - BLERJE
(KUOTASH)

Ne Tirane, sot me date 5 .06.2019 (dymije e nentembdhjete), perpara meje Noterit Ajtena Zela, me adrese ne Lagjia nr 1 Kruje, u paraqiten palet e meposhtme kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash:

SHITESI:

Zj. Violeta Hoxha, atesia Ristem, shtetase shqiptare, lindur me 21.01.1985, ne Rranze Kruje, pajisur me leternjoftim elektronik me nr personal H 20522014 M, madhor me zotesi te plote per te vepruar;

BLERESI:

Z. Arjeta Haxhiu, atesia Fatmir, shtetase shqiptare, lindur me 01.07.1972, ne Kruje, pajisur me leternjoftim elektronik me nr personal H 25701012 W, madhore me zotesi te plote per te vepruar;

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkerisht do t'u referohemi si "Palet". Palet e lartpermendura me identitetin e te cilave u njoha nga dokumentet qe ata dorezuan, dhe sipas Vendimit te Asamblese se Shoqerise dhe sipas Ekstrakit te nxjerre nga QKB, kane tagra te plota per te vepruar dhe per te hyre ne kete Kontrate . Te dyja palet, personalisht me bene me dije, duke ushtruar vullnetin e tyre te lire, qe duan te lidhin kete marreveshje per Shit - Blerjen e kuotave ("Kontrata e Shit-Blerjes se Kuotave"), si me poshte vijon:

Te pergjithshme

A. Shitesi eshte zoterues i 1 (nje) kuotave, me vlere 1.000,000 (nje mije) Leke, ne Shoqerine "ELIOT 2018" shpk (me poshte referuar si shoqeria). Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 19.07.1985, me numer NUIS L 84319201 N.

B. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit kapitalit e shoqerise ELIOT 2018, prej 1 kuote dhe Bleresi deshiron te bleje sipas kushteve te kesaj kontrate dhe pas kalimit te kuotave behet pronar ne masen 100% te shoqerise "ELIOT 2018" shpk.

D. Ne perputhje me nenin 117 pika b "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave", te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise "Dispozitat e Pergjithshme per kontraten e shitjes", dhe ne

pergjithesi te legjislacionit shqiptar ne fuqi, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon nepermjet shitblerjes te kuotave dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje Bleresit, duke e garantuar plotesisht titullin e pronesise te pa renduar me barre dhe Bleresi nga ana tjetere blen nga Shitesi kuotat kundrejt nje cmimi te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1. Çmimi i plote i shitjes se kuotave qe **zj.Violeta Hoxha** tjeterson/shet ne favor te Arjeta Haxhiu, eshte ne vleren prej **1.000,000 (njemije lek)**

Neni 3

Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat

4.1 Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat nga Shitesi te Bleresi do te kryhet menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe vetem pas kryerjes se pageses se plote te cmimit te blerjes prej 1.000,000 lek.

Neni 5

Garancite

Shitesi ne lidhje me kuotat qe zoteron, garanton Bleresin:

5.1. Se eshte pronar i vetem i kuotave te shitura e nuk ekzistojne te drejta te parablerjes, te blerjes, te marrjes ose te opsionit te ndonje personi te trete ne lidhje me kuotat e shitura.

5.2. Se e drejta per perfitimim e dividendit mbi kuotat e fituara ne shoqerine do te mund te ushtrohet rregullisht.

5.3. Te gjitha te mirat ekonomike te perdorura nga shoqeria, te cilat jane te nevojshme ose te dobishme per aktivitetin ekonomik te shoqerise dhe per vazhdimin e pakufizuar te tyre pas dites se lidhjes se Kontrates se Shitblerjes se Kuotave , veçanerisht objektet pasurore jane ne pronen e vetme e shoqerise dhe nuk jane ngarkuar me te drejta ose pretendime te te treteve.

5.4 Bleresi merr perseiper cdo lloj detyrimi qe mund te kete kjo shoqeri

Neni 6

Regjistrimi

6.1 Kjo kontratet duhet te depozitohet brenda 30 diteve prane Qendres Kombetare te Biznesit, me qellim reflektimin e ndryshime te struktures se ortakerise se Shoqerise prane ketij regjistri.

Neni 7

Ligji i zbatueshem

7.1. Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare", neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji "Per Qendren Kombetare te Biznesit" si dhe perkatesisht dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreshjeve

8.1. Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tirane.

Neni 9

Te ndryshme

Nenet e pergjithshme jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

Kjo kontrate mund te ndryshoje vetem me pelqimin e te dyja paleve duke respektuar formen shkresore te noterizuar.

Per sa me siper, ky akt hartohet nga une noterja ne 5 (pese) ekzemplare me vlere te njejte ligjore dhe kuptimore, referuar vullnetit te paleve nenshkruese dhe ligjit, ne perputhje te plote me Ligjin nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", vertetohet nenskrimin e tyre.

Shitesi

Violeta Rexha



Bleresi

Argjeta Hoxhiu



NOTERE PUBLIKE

Argjeta Hoxhiu

